



Prishtinë: 23.06.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1258_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Dëshmitë e paraqitura nga palët; dhe
- Rekomandimin e ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_2058_06_20**.

në seancën e mbajtur më datë 23.06.2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET pjesërisht** ankesa e konsumatorit M.D. nga Komuna e Pejës si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.
- II. **OBLIGOHET KESCO** që konsumatorin me shifër DPE – 9038562 ta ngarkoj me korrigjim shtesë për periudhën 01/2014 – 07/2014 ashtu që konsumatori të ngarkohet vetëm me diferencën e mesatares së shpenzimit të periudhës 01/2015 – 07/2015 me periudhën 01/2014 – 07/2014 (ku periudha e muajit 07/2014 të jetë vetëm për 7 ditë).

A r s y e t i m

Pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) është parashtruar ankesa nga konsumatori M.D. me shifër **DPE - 9038562** me të cilën është kundërshtuar përgjigja e lëshuar nga KESCO, lidhur me kontestimin e korrigjimit plotësues 54370DPE – 903562 datë 04.09.2014, për shkak të matjes jo të saktë të njehsorit elektrik nr.96256512.

Bordi i ZRRE-së, me qëllimit të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike e cila është iniciuar nga palët në kontest lidhur me pikën matëse të theksuar më lartë ka shqyrtuar dhe analizuar në detaje të gjitha dëshmitë e mbledhura për veprimet e ndërmarra nga palët në kontest lidhur me këtë pikë matëse.

Me datë 07.07.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e Grupeve matëse me kërkesë të Departamentit të Auditimit kanë inspektuar Grupin matës nr.96256512 ku kanë konstatuar se duhet të bëhet ndërrimi i TMRR-ve, si dhe që njëra TMRR nuk ka bërë matje, me ç'rast edhe shpenzimet e konsumatorit janë regjistruar për 1/3 më pak.

Provë: Procesverballi – Protokollin mbi montimin–demontrimin dhe ndërrimin e grupit matës nr. 004147 i datës 07.07.2017.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 04.09.2014 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr.54370DPE-9038562 në vlerë financiare **3,761.32€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 01/2014 deri me 07/2014.

Provë: Korrigjimi nr.54370DPE-9038562 i datës 04.09.2014.

Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues nr.54370DPE-9038562 e datës 04.09.2014.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KESCO.



Me datë 16.10.2017 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe Procesverbalit – Protokollit mbi montimin–demontimin dhe ndërrimin e grupit matës nr. 004147 datë 07.07.2017.

Provë: Përgjigja e KESCO-s e datës 16.10.2017.

Me datë 01.12.2017 konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së duke kundërshtuar përgjigjën e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar t'i shqyrtohet korrigjimi plotësues 54370DPE-9038562 datë 04.09.2014.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së datë 01.12.2017.

Bordi i ZRRE-së, duke i analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga konsumatori dhe KESCO, ka vërejtur se:

Punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e Grupeve matëse me datë 07.07.2014 me kërkesë të Departamentit të Auditimit kanë inspektuar Grupin matës nr.96256512 ku kanë konstatuar se bëhet ndërrimi i TMRR-ve, si dhe që njëra TMRR nuk ka bërë matje, me ç'rast edhe shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit janë regjistruar për 1/3 më pak. Sipas të dhënave të evidentuara në procesverbal nga punëtorët e KEDS-it vërtetohet se gjendja e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.96256512 janë TL=5864,312 kWh dhe TU=1959,200 kWh, dhe R1=4064,763 kVAr dhe R2=975,213 kVAr.

Provë: Procesverbali – Protokoli mbi montimin–demontimin dhe ndërrimin e grupit matës nr. 004147 i datës 07.07.2014.

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 04.09.2014 bazuar në procesverbalin – Protokollin mbi montimin–demontimin dhe ndërrimin e grupit matës nr.004147 të datës 07.07.2014 ka bërë korrigjimin plotësues 54370DPE-9038562 në vlerë **3,761.32€** për faturat 01/2014 deri në periudhën 07.07.2014 duke ri faturuar faturat e asaj periudhe (periudhën 01.01.2014 deri me 07.07.2014) për shkak të mos matjes së saktë të shpenzimit të energjisë elektrike prej **33%**. Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kundërshtuar korrigjimin plotësues nr.54370DPE-9038562 të datës 04.09.2014. Departamenti për Konsumator në KESCO me datë 16.10.2017 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, si dhe Procesverbalit – Protokollit mbi montimin–demontimin dhe ndërrimin e grupit matës nr. 004147 të datës 07.07.2017.

Provë: Korrigjimi plotësues nr.54370DPE-9038562 i datës 04.09.2014, ankesa e konsumatorit në KESCO, përgjigja e KESCO-s e datës 16.10.2017.

ZRRE ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit. Duke pasur parasysh që njehsori i konsumatorit lexohet nga distanca përkatësisht përmes AMR, Bordi i ZRRE ka analizuar edhe leximet/regjistrimet e shpenzimit të energjisë elektrike të bëra në njehsorin nr.96256512 dhe konstaton se konsumatori ka ndryshim në shpenzim të energjisë elektrike për periudhat para rregullimit të gjendjes, si dhe pas rregullimi të matjes. Sipas rrjedhës së energjisë për periudhat e njëjta të mëhershme vërehet se mesatarja e shpenzimeve është: për periudhën 01/2011 deri me 07/2011 është **22,780 kWh/muaj**, për periudhën 01/2012 deri me 07/2012 është **18,418 kWh/muaj**, për periudhën 01/2013 deri me 07/2013 është **17,980 kWh/muaj**, për periudhën kontestuese 01/2014 deri me 07/2014 është **13,022 kWh/muaj**, për periudhën 01/2015 deri me 07/2015 është **15,081 kWh/muaj**, për periudhën 01/2016 deri me 07/2016 është **15,634 kWh/muaj**, për periudhën 01/2017 deri me 07/2017 është **14,938 kWh/muaj**, për periudhën 01/2018 deri me 07/2018 është **16,497 kWh/muaj**, për periudhën 01/2019 deri me 07/2019 është **15,464 kWh/muaj**, si dhe periudhën 01/2020 deri me 05/2020 është **12,954 kWh/muaj**. Nga rrjedha e energjisë elektrike shihet se në



periudhën e vitit 2014 ka rënie të shpenzimit të energjisë elektrike në krahasim me periudhat para dhe pas kësaj periudhe.

Provë: Korrigjimi plotësues 54370DPE-9038562 datë 04.09.2014.

ZRRE thekson se në nenin 4.11.2 të Kodit të Matjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, theksohet se: *“Në rastin kur konstatohet se njëtori ka gabuar 100, nuk ka regjistruar fare, atëherë korrigjimi i energjisë elektrike do të bëhet sipas mesatares paraprake të shpenzimit të konsumatorit, gjithashtu të rastet e defektit të ndonjë sistemi matës (pa ndonjë ndërhyrje të qëllimshme) veprohet me mesatare duke zbritur shpenzimin e regjistruar dhe faturuar”*. Pra duhet theksuar se sipas nenit të lartcekur kur kemi të bëjmë me raste të defektit të ndonjë sistemi matës, atëherë korrigjimi i faturave të energjisë elektrike do të duhej të bëhej sipas këtij paragrafi të Kodit të Matjes së OSSH.

Bordi i ZRRE duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës, ku në Procesverbalin – Protokolin mbi montimin–dëmontimin dhe ndërrimin e grupit matës nr.004147 të datës 07.07.2014 theksohet se gjatë ndërrimit të TMRR-ve, është konstatuar se njëra TMRR nuk ka bërë matje, me ç’rast edhe shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit janë regjistruar për 1/3 më pak, shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit gjatë periudhës së vitit 2014 (periudha kontestuese) kanë një rënie në krahasim me periudhat tjera pas dhe para periudhës kontestuese, si dhe duke u bazuar në nenin 4.11.2 të Kodit të Matjes së OSSH, konstaton se korrigjimi i KESCO bërë konsumatorit nuk është i saktë dhe si i tillë duhet të korrigjohet, pasi nuk është vepruar konform këtij neni. DMK konstaton se korrigjimi shtesë i konsumatorit nga ana e KESCO për periudhën 01/2014 – 07/2014 duhet të bëhet ashtu që konsumatori të ngarkohet vetëm me diferencën e mesatares së shpenzimit të energjisë elektrike të periudhës 01/2015 – 07/2015 me periudhën 01/2014 – 07/2014 (ku periudha e muajit 07/2014 të jetë vetëm për 7 ditë).

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 23.06.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit: M. D.
- KESCO-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së.